




Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

Arritja e ekulibrit: Amandamenti i Ligjit të Punës

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka biseduar me 400 punëdhënës, 1,301 gra dhe 374 burra në Kosovë për të kuptuar se cilat janë mangësitë e pushimit aktual të lehonisë dhe atësisë dhe çfarë ndikimi kanë tek gratë, burrat, familjet, punëdhënësi dhe shteti. Më poshtë janë gjetjet tona.

Fakte

1. Edhe pse nënat mund të marrin deri në 12 muaj pushimin e lehonisë, shumica prej tyre **kthehen në punë pas 7 muajve pushim dhe paguhen vetëm për 6 muaj.**
2. Sipas statistikave gratë që qëndrojnë më gjatë në pushim **kanë më pak gjasa** të kthehen në punë.
3. Etërit në Kosovë **duan të kalojnë më shumë kohë me fëmijët** e tyre sesa 2-3 ditë! Ky **diskriminim** iu mohon baballarëve të drejtën për të marrë pjesë në kujdesin e fëmijëve të tyre të sapolindur. Shumica e baballarëve duan të kalojnë së paku një muaj me fëmijën e tyre të posalindur, ndërsa **49%** duan edhe më gjatë.
4. **Bizneset ankohen** për barrën e madhe financiare që paraqet pushimi i lehonisë
5. **Gati gjysma e punëdhënësve** të intervistuar nga RrGGK kanë thënë se i marrin parasysh planet familjare të punë-kërkuesve, ndërsa shumë prej tyre kishin **refuzuar të punësonin gra** për shkak të shpenzimeve të pushimit të lehonisë. **Gratë në Kosovë diskriminohen në punësim.**
6. Vetëm **21%** të grave janë të përfshira në tregun e punës. Pushimi i lehonisë është një arsye →  shtesë për të mos punësuar gra.
7. Kosova nuk ka taksapagues dhe punëtorë/e të mjaftueshëm/e për krijimin e një fondi social që do të mbështeste pushimin, duke vështirësuar situatën edhe më shumë, veçanërisht në krahasim me vendet e tjera, përfshirë edhe ato në rajon.
8. Kosova ka situatën më të keqe shëndetësore për nënat dhe fëmijët e posalindur në Evropë.

Sistemi aktual

Nënat mund të marrin gjithsej **12** muaj pushim të lehonisë =

6 muaj të pushimit mbulohen nga punëdhënësi, me 70% të rrogës.

3 muaj mbulohen nga qeveria, me 50% të rrogës mesatare të Kosovës.

3 muaj tjera janë të papaguara.


Baballarët kanë të drejtë të marrin **2 deri në 3 ditë pushim** pas lindjes së fëmijut.



Informacione me rëndësi:

- Hulumtimi i RrGGK-së ka treguar se punëdhënësit, sidomos kur janë burra, **nuk preferojnë të punësojnë gra.**
- **Shumë punëdhënës nuk dijnë** sa kohë ligjërisht iu takon grave dhe burrave për pushim të lehonisë dhe atësisë, dhe **nuk dijnë** se grave iu takojnë të drejta shtesë sa i përket **të ushqyerit me gji dhe kushte të sigurta të punës.**
- **62.7%** të grave dhe **65.9%** të burrave të intervistuar nga RrGGK thanë se **punëdhënësit i kanë pyetur për statusin e tyre martesor dhe planet e tyre për të krijuar familje.**
- 40 gra të intervistuar nga RrGGK madje thanë se punëdhënësit e tyre i kishin detyruar të kryenin teste të shtatzënisë para se të punësoheshin që të vërtetohet se ato nuk janë shtatzënë!
- Disa punëdhënës thanë se **nuk ofrojnë pushim të atësisë.**
- **Gati gjysma e grave** të cilat kanë marrë pushim të lehonisë thanë se kanë përjetuar **komente negative nga punëdhënësi apo kolegët e tyre kur janë kthyer në punë.**

Gra tjera thanë se pas pushimit të lehonisë janë detyruar të punojnë jashtë orarit, të pranojnë ulje të rrogës, apo në disa raste nuk janë lejuar fare të kthehen në punë.



Alternativa e RrRGK-së

Duke pasur parasysh situatën aktuale në Kosovë, RrGGK ka propozuar një alternativë për pushim të lehonisë, atësisë dhe skemë të pushim prindëror si më poshtë:

Punëdhënësit Garantojnë: 3 Muaj Pushim të Lehonisë dhe Atësisë

- Nënata: marrin 80% të rrogës të tyre për 3 muaj. Pushimi mund të fillojë para lindjes.
- Baballarët: marrin 80% të rrogës së tyre nga punëdhënësi i tyre për për 3 muaj. Pushimi mund të fillojë kurdo deri në ditëlindjen e parë të fëmijut.
- Ky pushim mund të merret së bashku, apo ndaras. Varësisht si vendosin vetë prindërit.
- Nëse pushimi mirret nga të dy prindërit në të njëjtën kohë, vetëm 7 muaj të pushimit të lehonisë dhe atësisë paguhen plotësisht (3 muaj nga punëdhënësi dhe 4 nga qeveria). Nëse pushimi mirret së pari nga njëri prind dhe pastaj nga tjetri, familja ka 10 muaj pushim me pagesë (krahasuar me 9 tani).

Qeveria Garanton: 4 Muaj Pushim të Lehonisë dhe/ose Atësisë

- Nënata: marrin 70% të rrogës mesatare në Kosovë për 4 muaj.
- Baballarët: marrin 70% të rrogës mesatare në Kosovë për 4 muaj.
- Në total, prindërit kanë 4 muaj pushim që i ndajnë së bashku, të paguar nga shteti.

2 Muaj të Papaguara

Këta muaj mund të shfrytëzohen nga njëri prind apo të ndahen mes të dy prindërve. Drejta e prindërve për t'u kthyer në punë pas këtij pushimi është e garantuar. Nëqoftëse merret edhe ky pushim, një familje mund të ketë gjithsej 12 muaj pushim të lehonisë dhe atësisë, 10 prej tyre të paguar.!

Rekomandime tjera

Kjo alternativë kërkon po ashtu:

Çasje më të mirë në përkujdesje ditore për fëmijë të përballeshme financiarisht që prindërit të kenë mundësi të kthehen në punë
Pauza të paguara gjatë orarit të punës **për ushqyerje me gjë**, çdo kohë pas përfundimit të pushimit të lehonisë.
garantimi i kushteve të sigurta të punës për gratë shtatzëna, si dhe të drejta tjera.

Për informata shtesë apo për të lexuar dokumentin e kompletuar Arritja e ekulibrit vizitoni:

www.womensnetwork.org

Pse këtë model?

- Shumica e grave në Kosovë marrin pushim të lehonisë për 6 muaj - ky sistem mundëson 6 muaj të paguar për ato, si dhe 2 muaj shtesë.
- Ky sistem i garanton baballarëve 6 muaj të paguar të pushimit të atësisë, krahasuar me 2-3 ditë nën sistemin aktual!
- E drejta e barabartë e babait dhe nënës për të marrë pushim të lehonisë/atësisë do të zvogëlojë nivelin e diskriminimit të grave në punësim.
- Pra, me këtë sistem hiqet pushimi i lehonisë si arsye për të mos pranuar një grua në një vend pune pasi që gratë dhe burrat trajtohen barabartë.
- Ky model përmirson kushtet e jetës së familjeve duke ruajtur mirëqenien e nënës dhe fëmijës.
- Kjo alternativë pothuajse përgjysmon shpenzimet për punëdhënësit, duke kursyer atyre 648 euro për fëmijë!

